

VENDIM
Nr. 672, datë 15.10.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA
VERIORE KORÇË (DRITAT E VERDHA
- KRYQËZIMI, RRUGA KORÇË -
KAPSHTICË) SHITESAT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit "Unaza veriore Korçë (Dritat e verdha - kryqëzimi, rruga Korçë - Kapshticë) shtesat".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë "arë" dhe "truall", me vlerë 7 913 115.20 (shtatë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë pikë njëzet) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 7 913 115.20 (shtatë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë pikë njëzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri "Detyrimet e prapambetura (detyrimet e infrastrukturës)".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4, 5 dhe 6, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA, TË BRENDSHME DHE SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NE SEGMENTIN RRUGOR
"UNAZA VERIORE KORÇË" (DRITAT E VERDHA-KRYQ. RRUGA KORÇË-KAPSHTICE) SHITESAT

N r	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kada str.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Sip. (m²)	TOKË TRUALL		TOKË ARË		Vlera Totale (lekë)	Shënime
								Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Klea		Sevo +bp.	8561	1/751	2700	350	10000	3500000			3500000	Konfirmim ZVRPP
2	Mishel		Stefanllar i + bp.	8562	6\64	117.2	23	10000	230000			230000	Konfirmim ZVRPP
3	Luan	Shefqet	Banaj	8562	6/190	74.5	22	10000	220000			220000	Konfirmim ZVRPP
4	Fiqiriye		Gjata + bp.	8562	6/469	280	53	10000	530000			530000	Konfirmim ZVRPP
5	Fiqiriye		Gjata + bp.	8562	6/334	16.5	16.5	10000	165000			165000	Konfirmim ZVRPP
6	Spiro	Fane	Gjoni	1101	204/22	1760	75			279.4	20955	20955	Konfirmim ZVRPP
7	Klea	Vasilla q	Spiro	8561	11\82	1163	86	10000	860000			860000	Konfirmim ZVRPP
8	Ilia	Ligor	Tili	8561	10/183	22196	163	10000	1630000			1630000	Certifikatë pronësie
	Bertha		Çili (Tili)			2521. 3							Certifikatë pronësie
9	Theodhora		Ndili	8561	10/181		72	10000	720000			720000	Konfirmim ZVRPP
10	Sali	Tefik	Ravolli	1101	218/10	8300	133			279.4	37160.2	37160.2	Konfirmim ZVRPP
							993.5		7855000		58115	7913115.20	